

[stampa](#) | [chiudi](#)

# HERMESNEWS

## videoblog - blog - services

diretto e curato da Dorian Metollari

Attualitet

1/5/2008 8:55:25 AM

## Bajze: Pritet largimi i pesticideve nga stacioni hekurudhor

Rehabilitimi i mjedisit nga ndotja ne zonen e Bajzes nis me heqjen e pesticideve te mbetura ne nje magazine ne stacionin hekurudhor. Aty kimikate e rrezikshme gjenden te perhapura ne mjedis te hapur, pasi ambalazhi i tyre prej letre eshte i grisur vite me pare.

**5** janar 2008 Kimikate helmuese te depozituara ne vitet '90 ne nje magazine ne stacionin hekurudhor te Bajzes pritet te hiqen duke shmangur edhe rrezikun nga ndotja. Rehabilitimi nga ndotja I Bajzes do te kryhet ne zbatim te projektit "Forcimi i kapaciteteve ne vendet e Ballkanit Perendimor per te adresuar pikat e nxehta mjedisore nepermjet nje modeli te integruar". Koordinator i projektit, Lirim Selfo, tha se Kohezgatja e projektit eshte 30 muaj dhe do te financohet (ne forme granti) nga qeveria holandeze dhe kontributet perkatese te vendeve pjesemarrese ne projekt.

Projekti do te realizohet ne bashkepunim me Ministrine e Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit te Ujerave, si dhe institucione te tjera qendrore dhe vendore, perfshire organizatat jofitimpruese, dhe ka si objektiv specifik largimin e kimikateve te rrezikshme nga stacioni hekurudhor ne Bajze dhe pastrimin e territorit nga ndotja e shkaktuar nga keto kimikate. Ne te marrin pjese vec Shqiperise, Bosnje-Hercegovina, Kosova, Mali i Zi, Maqedonia dhe Serbia. Aktualisht ne Bajze, ne magazine ku jane depozituar mbetjet te gjitha ambalazhet prej thase letre, ku ishin paketuar kimikate e rrezikshme, jane te demtuara dhe pjesa dermuese e tyre jane perzier me copa te vogla lekure qe gjenden te depozituara ne te njejten magazine dhe perzier me keto kimikate. Copat e lekures jane gjithashtu te depozituara prej shume vitesh, me qellim per t'u eksportuar si lende e pare. Nder rezultatet e prishme jane: pastrimi dhe rehabilitimi i plote i zones ku jane perqendruar stoqet e kimikateve toksike ne stacionin hekurudhor te Bajzes, duke mundesuar ne kete menyre qeverine lokale dhe stacionin hekurudhor te Bajzes te perdorin plotesisht magazinene e rehabilituar dhe te permiresojne kushtet per zhvillimin e qendrueshem te zones. Pas largimit dhe eliminimit te ndotjeve nga magazina e kimikateve pritet studimi i nivelit te ndotjes se tokes nga pesticidet, ne sipërfaqe dhe thellesi, shtrirja ne hapësirë e ndotjes, perfshi edhe ndotjen eventuale te ujerave sipërfaqesore dhe nentokesore.

© 2007 HermesNews

[stampa](#) | [chiudi](#)